



Prof. Dr. Robert Çina. Lektor, Dekan

Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane
Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit
Universiteti i Sporteve të Tiranës

rcina@ust.edu.al
+355 69 20 38 656

Bio e shkurtër

Prof. Dr. Robert Çina ka kryer studimet e larta pranë Fakultetit të Mjeksisë së Përgjithshme në Universitetin Shtetëror të Tiranës në 1983. Deri në Vitin 1986 ka punuar si mjek i përgjithshëm pranë Spitalit Civil dhe Urgjencës së Poliklinikës Kukës. Në 1986 është emëruar Asistent Pedagog pranë Institutit të Lartë të Kulturës Fizike, Tiranë. Në Vitin 1988 u emërua Pedagog pranë të njëjtit Institucion, pozicion që e mban edhe sot. Fusha kryesore studimore ka qenë studimi i modifikimit të aparatit kardiovaskular si pasojë e stërvitjes specifike në sporte të dryshme, si edhe sjellja e këtij sistemi gjatë ushtrimit fizik duke krahasuar grupe të ndryshme sportistësh. Pikërisht në këtë fushë në vitin 1996, mbrojti punimin e Doktoraturës me temë: “Vlerësimi i ndryshimeve morfo-funksionale të aparatit kardio vaskular gjatë ushtrimit fizik në sporte të ndryshme”. Prof. Dr. Robert Çina gjatë periudhës 2006-2010, ka qenë pedagog i jashtëm pranë “Fakultetit të Edukatës Fizike” në “Universitetin e Tetovës” ku ka dhënë mësim për nivelin “Bachelor” dhe “Master”. Gjithashtu po gjatë periudhës 2006-2010 ai ka mbajtur edhe funksionin e Përgjegjës të Departamentit të Mjeksisë Sportive pranë Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe anëtar i zgjedhur i Senatit të UST. Githashtu Prof. Dr. Robert Çina ka kryer funksionin e sekretarit të përgjithshëm të Shoqatës së Mjeksisë Sportive dhe anëtar i Komisionit Mjekësor pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Në Vitin 2011 ka marrë titullin Profesor i Asociuar dhe në vitin 2015 ka fituar titullin Profesor Doktor. Në vitin 2021 dhe në vazhdim mban pozicionin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.